REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 498 **Prot** **Krumë me,** 04 / 02 /**2026**

LËNDA: Përcjellje e Rregullores së Brendshme të Auditimit dhe Urdhrit të Kryetarit për zbatim.

DREJTUAR: Të gjitha Strukturave dhe Drejtorive të Bashkisë Has

PËR DIJENI: Z. Miftar Dauti, Kryetar i Bashkisë Has

Të nderuar kolegë,

Në vijim të procesit të rritjes së standardeve të punës dhe llogaridhënies në institucionin tonë, bashkëlidhur ju përcjellim **Urdhrin e Kryetarit Nr.** 75 **, datë** 04 / 02 **/2026**, së bashku me Rregulloren e Brendshme të Njësisë së Auditimit të Brendshëm të miratuar.

Kjo rregullore përcakton parimet etike, të drejtat dhe detyrimet e secilit prej nesh gjatë proceseve audituese, si dhe masat për sigurimin e një kontrolli efektiv mbi asetet dhe financat e Bashkisë Has.

Lidhur me sa më sipër, kërkohet nga drejtuesit e çdo strukture:

1. Të njoftoni të gjithë punonjësit nën varësinë tuaj për përmbajtjen e këtij dokumenti.
2. Drejtuesit e strukturave të sigurojnë që çdo punonjës të ketë akses të plotë në versionin fizik ose elektronik të kësaj rregulloreje. Rregullorja do të qëndrojë e afishuar në faqen zyrtare të Bashkisë Has.
3. Të garantohet bashkëpunimi i plotë me Njësinë e Auditimit të Brendshëm sipas kërkesave të në zbatim të kësaj rregulloreje.

Rregullorja është gjithashtu e aksesueshme në versionin elektronik në faqen zyrtare të Bashkisë. Për çdo paqartësi teknike, mbetemi në dispozicionin tuaj për sqarime të mëtejshme.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Esmeralda Zyberaj

***Adresa**: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 499 **Prot** **Krumë me,** 09/02 **/2026**

U R D H Ë R

Nr. 75 **, Datë** 09 /02 **/2026**

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES

" PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM, BASHKIA HAS"

Në mbështetje të:

- Nenit 64, pika "dh" e Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
- Ligjit nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" (i ndryshuar);
- Strukturës dhe Organikës së Bashkisë Has, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak;

Me qëllim rritjen e llogaridhënies, përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në institucion,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Të gjithë nëpunësit dhe punonjësit e Bashkisë Has janë të detyruar të njihen individualisht me këtë rregullore. Njësia e Auditimit dhe Sektori i Burimeve Njerëzore do të organizojnë seanca informuese sipas nevojës.
3. Për çdo interpretim apo paqartësi lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje, punonjësit mund të kërkojnë sqarime pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore ose Drejtuesit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm.
4. Për punonjësit, detyrat e të cilëve nuk parashikohen në këtë rregullore, mbetet në fuqi kontrata individuale e punës (sipas Kodit të Punës), statusi i nëpunësit civil dhe legjislacioni sektorial në fuqi.


Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has, Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

5. Moszbatimi i kërkesave të kësaj rregulloreje ngarkon punonjësit me përgjegjësi disiplinore sipas sanksioneve të parashikuara në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" ose Kodit të Punës.
6. Ky urdhër dhe rregullorja bashkëngjitur të publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë Has.
7. Ngarkohet Njësia e Auditimit të Brendshëm, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe të gjitha strukturat e tjera të Bashkisë Has për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Miftar DAUTI



Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
OBASHKIA HAS
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RREGULLORE E BRENDSHME

" PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN

E

NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM,

BASHKIA HAS"

VITI 2026

***Adresa**: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

PËRMBAJTJA

KREU I: QËLLIMI, AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSIA
Neni 1: Misioni dhe Qëllimi i Auditimit të Brendshëm.....
Neni 2: Përmirësimi i Veprimtarisë Institucionale.....
Neni 3: Efektiviteti dhe Pavarësia.....
Neni 4: Fusha e Veprimit dhe Siguria e Ofruar.....
Neni 5: Korniza Ndërkombëtare dhe Etika.....
KREU II: BAZA LIGJORE DHE STANDARDET PROFESIONALE
Neni 6: Kuadri Ligjor Rregullator.....
Neni 7: Standardet Profesionale dhe Roli i tyre si Udhëzues.....
Neni 8: Aktet e Brendshme të Bashkisë.....
KREU III: PROFESIONALIZMI DHE ETIKA
Neni 9: Parimet e Etikës dhe Sjellja Profesionale.....
Neni 10: Zbatimi i Standardeve Globale të Etikës (SGAB) .....
Neni 11: Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional.....
Neni 12: Përgjegjës i grupit të auditimit.....
Neni 13: Audituesi i certifikuar.....
Neni 14: Auditues i pa certifikuar.....
KREU IV: ROLET, PËRGJEGJËSITË DHE KARTA E AUDITIMIT
Neni 15:Mandati dhe Karta e Auditimit të Brendshëm.....
Neni 16: Autoriteti dhe Aksesi i Pakufizuar.....
Neni 17: Shërbimet e Auditimit dhe Fushëveprimi.....
Neni 18: Përgjegjësitë e Titullarit të Bashkisë Has.....
Neni 19: Përgjegjësitë e Menaxhimit të Lartë .....
Neni 20: Përgjegjësitë e Njësisë së Audituar (Drejtoritë/Sektorët) .....
Neni 21: Komiteti i Auditimit (KA) .....
Neni 22: Përgjegjësitë e Drejtuesit të Auditimit të Brendshëm.....
KREU V: KOORDINIMI DHE MARRËDHËNIET ME JASHTË
Neni 23: Metodologjia e Punës dhe Përmirësimi i Funksionit.....
Neni 24: Koordinimi me Ofruesit e Sigurisë dhe Shërbimet e Jashtme.....
Neni 25: Raportimi te Struktura e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (Ministria e Financave) .....
Neni 26: Marrëdhëniet me Inspektimin Financiar.....
KREU VI: LIOJET E ANGAZHIMEVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
Neni 27: Shërbimet e Sigurisë.....
Neni 28:Shërbimet e Këshillimit.....
KREU VII: PLANIFIKIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM
Neni 29: Natyra Strategjike e Planifikimit.....
Neni 30: Auditimi i Bazuar në Risk.....

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Neni 31: Burimet dhe Metodologjia.....
KREU VIII: KUPTIMI I QEVERISJES, RISKUT DHE KONTROLLIT
Neni 32: Vlerësimi i Proceseve të Qeverisjes.....
Neni 33: Menaxhimi i Riskut .....
Neni 34: Proceset e Kontrollit dhe Matrica e Riskut.....
Neni 35: Lidhja me Strategjinë e Auditimit.....
Neni 36: Miratimi dhe Afatet e Planeve.....
KREU IX: FAZAT E KRYERJES SË ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT
Neni 37: Fillimi dhe Planifikimi i Angazhimit.....
Neni 38: Puna në Terren.....
Neni 39: Raportimi i Rezultateve.....
Neni 40: Ndjekja e Rekomandimeve (Follow-up) .....
KREU X: PAVARËSIA DHE OBJEKTIVITETI
Neni 41: Dimensionet e Pavarësisë.....
Neni 42: Raportimi Funksional dhe Administrativ.....
Neni 43: Mbrojtja ndaj Ndërhyrjeve (Cenimi i Pavarësisë) .....
Neni 44: Kufizimet për Rolet Jo-Audituese (Rregulli i 3 Viteve) .....
Neni 45: Masat Mbrojtëse dhe Zgjidhja e Konflikteve.....
Neni 46: Dokumentimi dhe Ruajtja e Letrave të Punës (Arkivimi).....
Neni 47: Mbrojtja e Informacionit dhe Aksesi i Palëve të Treta.....
KREU XI: PROGRAMI I SIGURIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË (PSPC)
Neni 48: Qëllimi dhe Fushëveprimi i PSPC.....
Neni 49: Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë.....
Neni 50: Treguesit Kryesorë të Performancës.....
Neni 51: Vlerësimet e Jashtme të Cilësisë.....
Neni 52: Raportimi dhe Plan Veprimi për Cilësinë.....
KREU XII: DISPOZITA PËRFUNDIMTARE
Neni 53: Njohja dhe zbatimi i rregullores.....
Neni 54: Masat Disiplinore dhe Sanksionet.....
Neni 55: Hyrja në Fuqi dhe Rishikimi.....

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

KREU I

QËLLIMI, AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSIA

Neni 1
Misioni dhe Qëllimi i Auditimit të Brendshëm

Ky dokument përcakton rregullat e funksionimit, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has. Auditimi i brendshëm në Bashkinë Has është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshilla për menaxhimin, e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e institucionit. Ky funksion ndihmon institucionin e Bashkisë Has për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceseve të kontrollit e të qeverisjes.

Deklarata e Qëllimit: Auditimi i brendshëm forcon aftësinë e Bashkisë Has për të krijuar, mbrojtur dhe mbështetur vlerën, duke i ofruar Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak (Bordit) siguri, këshillë, transparencë dhe largpamësi të pavarur.

Neni 2
Përmirësimi i Veprimtarisë Institucionale

Auditimi i brendshëm në Bashkinë Has synon të përmirësojë:

- Arritjen e objektivave duke siguruar që shërbimet ndaj qytetarëve të Hasit të kryhen me sukses.
- Vendimmarrjen dhe Mbikëqyrjen duke ofruar të dhëna të sakta për vendimmarrjen e titullarit.
- Reputacionin dhe Besueshmërinë duke rritur besimin e publikut dhe palëve të interesuara te institucioni.
- Interesin Publik duke siguruar që fondet dhe asetet e Bashkisë përdoren në shërbim të komunitetit.

Neni 3
Efektiviteti dhe Pavarësia

Auditimi i brendshëm në Bashkinë Has konsiderohet efektiv kur:

1. Kryhet nga auditues kompetentë në përputhje me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm.
2. Njësia e Auditimit (NJAB) është e pozicionuar në mënyrë të pavarur, me llogaridhënie të drejtpërdrejtë te Kryetari i Bashkisë.
3. Audituesit nuk përfshihen nga ndikime të panevojshme dhe bëjnë vlerësime objektive, pa pasur role operacionale në administratë.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has, Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Neni 4
Fusha e Veprimit dhe Siguria e Ofruar

1. Puna e auditimit bazohet në risk dhe përfshin të gjitha operacionet financiare dhe jo-financiare të Bashkisë Has, përfshirë ndërmarrjet varëse dhe njësitë administrative.
2. Audituesi ofron siguri të arsyeshme se veprimtaritë janë efektive, raportimi është i besueshëm, ligjet respektohen dhe asetet mbrohen.
3. Njësia e Auditimit të Brendshëm ndihmon drejtuesit e Bashkisë të ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontroll të rreptë mbi përdorimin e buxhetit dhe burimeve njerëzore.

Neni 5
Korniza Ndërkombëtare dhe Etika

Veprimtaria e auditimit në Bashkinë Has rregullohet sipas standardeve të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IAB). Çdo audites është i detyruar të zbatojë Kornizën Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale dhe Kodin e Etikës, duke kontribuar në qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e sistemit ku vepron.

KREU II

BAZA LIGJORE DHE STANDARDET PROFESIONALE

Neni 6
Kuadri Ligjor Rregullator

Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar. Ai përcakton rregullat kryesore për realizimin e procesit të auditimit të brendshëm për të garantuar kryerjen e auditimit në përputhje me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm. Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në Njësinë e Auditimit, si dhe përcakton: fushën e veprimit, objektivat, misioni, roli dhe parimet e auditimit të brendshëm, standardet dhe metodologjia, organizimi i auditimit të brendshëm, të drejtat dhe përgjegjësitë.

Kjo rregullore mbështetet në:

- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *"Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"*, i ndryshuar me ligjin nr. 12, datë 2.02.2023 *"Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*;
- Ligji nr 139/2015 *"Per vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar;
- Urdhëri i Ministrit të Financave Nr. 134, datë 17.10.2025 *"Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"*.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

- Urdhër nr. 103, datë 23.7.2025 "*Për miratimin e Strandardeve Globale të Auditimit të Brendshëm të Pranuara për zbatim në Sektorin Publik në Republikën e Shqipërisë*".
- Urdhëri Nr.86, datë 10.12.2015, "*Për miratimin e Kodit Etik të AB-së*".
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*";
- Urdhëri nr. 22, datë 6.3.2017, "*Miratimi i Metodologjisë për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së AB*";
- Urdhër nr. 42, date 27.10.2020 "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik*"
- Urdhër nr. 3, datë 08.01.2016 "Për miratimin e Rregullores për Trajnimin e Vijueshëm Profesional për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik", e ndryshuar.

Neni 7
Standardet Profesionale dhe Roli i tyre si Udhëzues

NJAB në Bashkinë Has zbaton në mënyrë të detyrueshme Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (IPPF) dhe Kornizën e Re Globale të Auditimit të Brendshëm. Këto standarde përbëjnë kornizën kryesore rregullatore për çdo angazhim auditues.

Profesioni i auditimit në Bashkinë Has ushtrohet si një profesion i vetëm global. Këto standarde janë të detyrueshme si për strukturën e Njësisë së Auditimit të Brendshëm ashtu edhe për audituesit përfshirë drejtuesit apo subjektet e jashtme të kontraktuara.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Standardet Globale zbatohen në sektorin publik pas miratimit me Urdhër të Ministrit të Financave (referuar Urdhrit Nr. 103, datë 23.7.2025).

Standardet shërbejnë si udhëzuesi thelbësor për të orientuar audituesit drejt integritetit dhe cilësisë, pavarësisht sfidave operacionale.

Çdo shmangie e mundshme nga këto standarde gjatë punës në terren duhet të arsyetohet me shkrim dhe t'i raportohet Titullarit, duke garantuar gjithmonë mbrojtjen e interesit publik dhe të aseteve të Bashkisë Has.

Neni 8
Aktet e Brendshme të Bashkisë

Përveç legjislacionit kombëtar, Njësia e Auditimit të Brendshëm udhëhiqet edhe nga:

1. Karta e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Has (e nënshkruar nga Kryetari).
2. Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Administratës së Bashkisë Has.
3. Urdhëra dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak që kanë efekt mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has, Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

KREU III

PROFESIONALIZMI DHE ETIKA

Neni 9
Parimet e Etikës dhe Sjellja Profesionale

Audituesit e brendshëm të Bashkisë Has duhet të sillen sipas standardeve më të larta etike dhe profesionale. Ata kanë detyrimin të promovojnë një kulturë etike në të gjithë organizatën. Veprimtaria e auditimit në Bashkinë Has mbështetet mbi këto parime bazë:

a) Ligjshmëria nënkupton respektimin e Kushtetutës, legjislacionit shqiptar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.
b) Paanësia nënkupton pasqyrimin objektiv, transparent dhe të vërtetë të të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e njësisë publike të audituar, pa u ndikuar nga interesi personal ose pikëpamjet e të tretëve;
c) Integriteti nënkupton ndershmëri, objektivitet, aftësi, shmangie e konfliktit të interesave në ushtrimin e veprimtarisë audituese;
d) Pavarësia dhe Objektiviteti nënkupton pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë audituese dhe dhënien e mendimeve e të gjykimeve objektive gjatë kryerjes së auditimeve;
e) Profesionalizmi dhe zhvillimi i vazhdueshëm professional që kërkon zbatimin e standardeve me kujdesin e duhur profesional, si dhe përpjekje të vazhdueshme për formimin e zhvillimin profesional, rritjen dhe përmirësimin e njohurive të çdo audituesi;
f) Kompetenca nënkupton zotërimin dhe përdorimin e njohurive, aftësive dhe eksperiencës së duhur në ushtrimin e veprimtarisë audituese;
g) Konfidencialiteti nënkupton respektimin e fshehtësisë së të dhënave dhe dokumenteve të administruara gjatë auditimit si konfidenciale.

Neni 10
Zbatimi i Standardeve Globale të Etikës (SGAB)

1. Të gjithë audituesit e brendshëm të Bashkisë Has duhet të veprojnë në përputhje të plotë me parimet dhe standardet e etikës dhe profesionalizmit të përfshira në Fushën "Etika dhe Profesionalizmi" të Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm (SGAB).
2. Në rastet kur Bashkia Has apo njësitë e saj varëse kanë një Kod Etike të veçantë ose akte të tjera rregullatore për etikën, audituesit e brendshëm janë të detyruar t'u përmbahen atyre, por pa cënuar asnjëherë standardet më të larta profesionale të kërkuara nga SGAB.
3. Audituesit duhet të kenë parasysh se fakti që një sjellje e caktuar nuk përmendet shprehimisht në këto parime, nuk e pengon atë të konsiderohet e papranueshme ose diskredituese për profesionin nëse ajo dëmton integritetin e institucionit.
4. Audituesit janë drejtpërdrejt përgjegjës për zbatimin e përditshëm të parimeve të etikës në punën e tyre.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has, Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

5. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm ka detyrimin të mbështesë dhe promovojë përputhjen me këto standarde, duke ofruar udhëzim dhe mundësi për trajnim të vazhdueshëm profesional.
6. Drejtuesi i auditimit të brendshëm mund të delegojë detyra specifike operacionale, por ai ruan përgjegjësinë përfundimtare për etikën, profesionalizmin dhe integritetin e të gjithë funksionit të auditimit të brendshëm në Bashkinë Has.

Neni 11
Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

Audituesit duhet të angazhohen në përpjekje të vazhdueshme për trajnim dhe zhvillim profesional, në përputhje me Rregulloren për Trajnimin e Vijueshëm Profesional, me qëllim rritjen e cilësisë së auditimeve në Bashkinë Has.

Neni 12
Përgjegjës i grupit të auditimit

Përgjegjës i grupit të auditimit caktohet nga drejtuesi i auditimit të brendshëm:

1. Udhëheq dhe organizon grupin në kryerjen e angazhimit në të gjitha fazat e tij (planifikim, puna në terren, raportim dhe zbatim të rekomandimeve);
2. Mbikëqyr punën audituese në mënyrë që të sigurohet se audituesit marrin mbështetjen e nevojshme, burimet e auditimit përdoren me eficience, ekonomi, efektivitet dhe se auditimi po kryhet:
   - sipas planit të miratuar;
   - në përputhje me metodologjinë dhe standardet e përcaktuara;
   - në nivel të përshtatshëm menaxhimi ose procesi të njësisë; dhe
   - me mënyrat më efiçente për punën audituese dhe përgatitjen e rekomandimeve. Për çështje të rëndësishme, Përgjegjësi i grupit i jep audituesit detyra me shkrim.
3. Nëse sipas gjykimit të përgjegjësit të grupit kërkohet të bëhet një shmangie nga programi i angazhimit të auditimi, kjo duhet të diskutohet me drejtuesin e auditimit të brendshëm, të dokumentohet dhe të miratohet;
4. Organizon punën për kryerjen e angazhimit në të gjitha fazat (planifikim, puna në terren, raportim dhe zbatim të rekomandimeve);
5. Ndan dhe dakortëson detyrat e grupit të punës, në rast mos dakordësimi i drejtohet drejtuesit te auditimit të brendshëm për vendimmarrje;
6. Harton programin e angazhimit të auditimit dhe e dërgon për miratim tek drejtuesi i auditimit të brendshëm;
7. Organizon dhe monitoron punën sipas ndarjes së detyrave për çdo auditues dhe për çdo drejtim të auditimit;
8. Komunikon në mënyrë të vazhdueshme për grupin e auditimit dhe njësinë e audituar lidhur me angazhimin sipas nevojës;

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

9. Në përfundim të punës në terren harton projekt raportin e auditimit duke konsoliduar pjesët e përgatitura dhe dorëzuara nga çdo auditues sipas ndarjes së detyrave;
10. Mban përgjegjësi dhe merr masa që të sigurojë cilësinë e projekt raportit / raportit të auditimit në përputhje me kërkesat ligjore.
11. Pas dakortësimit dërgon për miratim projekt raportin / raportin tek Drejtuesi i auditimit të brendshëm.

Neni 13
Audituesi i certifikuar

1. Pranon detyrat që ngarkohen nga Përgjegjësi i grupit të auditimit, në rast mos dakortësimi i drejtohet drejtuesi i auditimit të brendshëm për vendimmarrje;
2. Merr pjesë në hartimin e programit të angazhimit të auditimit;
3. Luan rol kyç në kryerjen e angazhimit në të gjitha fazat e tij (planifikim, puna në terren, raportim dhe zbatim të rekomandimeve) dhe mbikëqyr punën e audituesit/ve të pa certifikuar;
4. Kryen detyrat e përcaktuara nga Përgjegjës i grupit të auditimit brenda afateve;
5. Komunikon me përgjegjësin e grupit të auditimit lidhur me angazhimin sipas nevojës;
6. Në përfundim të punës në terren harton dhe dërgon brenda afateve materialin sipas ndarjes së detyrave;
7. Mban përgjegjësi për materialin që i dërgon përgjegjësit të grupit të auditimit dhe merr masa që të jetë sipas metodologjisë dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 14
Auditues i pa certifikuar

1. Pranon detyrat që ngarkohen nga Përgjegjësi i grupit të auditimit, në rast mos dakortësimi i drejtohet drejtuesit të auditimit të brendshëm për vendimmarrje;
2. Ndihmon përgjegjësin e grupit dhe audituesit e tjerë të grupit në hartimin programit të angazhimit të auditimit;
3. Ndihmon grupin në kryerjen e angazhimit në të gjitha fazat e tij (planifikim, puna në terren, raportim dhe zbatim të rekomandimeve) nën mbikqyrjen e audituesit/sve të certifikuar;
4. Kryen detyrat e përcaktuara nga Përgjegjës i grupit të auditimit brenda afateve;
5. Komunikon me përgjegjësin e grupit të auditimit lidhur me angazhimin sipas nevojës;
6. Mban përgjegjësi për materialin dhe rezultatet e auditimit të cilat më pas duhet t'i diskutojë me drejtuesin e auditimit të brendshëm ose audituesin e brendshëm të certifikuar dhe me eksperiencë që e mbikëqyr atë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

KREU IV

ROLET, PËRGJEGJËSITË DHE KARTA E AUDITIMIT

Neni 15
Mandati dhe Karta e Auditimit të Brendshëm

1. Mandati i NJAB në Bashkinë Has përcaktohet në Kartën e Auditimit të Brendshëm, e cila është akti administrativ që miratohet nga Titullari (Kryetari i Bashkisë).
2. Karta e Auditimit përcakton zyrtarisht:
   - Fuqinë ligjore për të ushtruar kontrolle.
   - Detyrimet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm ndaj institucionit.
   - Raportimi te Titullari dhe marrëdhënia me Komitetin e Auditimit.
3. Njësia e Auditimit të Brendshëm e realizon mandatin e saj përmes një qasjeje sistematike, të strukturuar dhe të orientuar drejt vlerësimit të qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm në të gjithë Bashkinë.

Neni 16
Autoriteti dhe Aksesi i Pakufizuar

1. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka autoritet të plotë, të lirë dhe të pakufizuar për të aksesuar:
   - Të gjitha sistemet, regjistrat dhe të dhënat (fizike dhe elektronike).
   - Të gjithë personelin e Bashkisë Has dhe njësive varëse.
   - Të gjitha pronat dhe asetet fizike të institucionit.
2. Çdo pengesë apo vonesë e qëllimshme nga ana e menaxhimit për të ofruar aksesin e kërkuar konsiderohet cënim i pavarësisë dhe raportohet menjëherë te Titullari.

Neni 17
Shërbimet e Auditimit dhe Fushëveprimi

Fushëveprimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm mbulon të gjithë veprimtarinë e Bashkisë Has, duke përfshirë njësitë administrative, ndërmarrjet varëse dhe çdo projekt të financuar nga buxheti i bashkisë apo donatorët.

Shërbimet kryesore përfshijnë:

- **Siguri Objektive:** Auditimet financiare, të përputhshmërisë, performancës dhe sistemeve të TI-së.
- **Këshillim Profesional:** Ofrimi i perspektivës strategjike për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Neni 18
Përgjegjësitë e Titullarit të Bashkisë Has

Titullari i Bashkisë Has, në funksion të garantimit të Pavarësisë Organizative, ka këto përgjegjësi kryesore:

1. Vendos një marrëdhënie raportimi të drejtpërdrejtë me drejtuesin e auditimit të brendshëm dhe funksionin e auditimit të brendshëm për t'i mundësuar funksionit të auditimit të brendshëm të përmbushë mandatin e tij.
2. Autorizon emërimin dhe shkarkimin e Drejtuesit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm, në përputhje me kuadrin ligjor për marrëdhëniet e punës dhe ligjin e auditimit.
3. Ofron të dhëna për menaxhimin e lartë për të mbështetur vlerësimin e performancës.
4. I jep Drejtuesit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm mundësinë për të diskutuar çështje me ndjeshmëri të lartë, përfshirë takimet pa praninë e pjesës tjetër të nivelit lartë drejtues (p.sh. Drejtorët e Drejtorive).
5. Siguron që Njësia e Auditimit të Brendshëm të pozicionohet në një nivel hierarkik që mundëson komunikimin e problemeve direkt te Titullari, pa ndërhyrje nga personeli tjetër brenda ose jashtë Bashkisë.
6. Vlerëson çdo rol jo-auditues që i ngarkohet NJAB-së për të shmangur cënimin e pavarësisë.
7. Bashkëpunon me nivelin e lartë drejtues dhe drejtorin e auditimit të brendshëm për të vendosur masa mbrojtëse të përshtatshme nëse rolet dhe përgjegjësitë e drejtuesit të auditimit të brendshëm dëmtojnë ose duket se dëmtojnë pavarësinë e funksionit të auditimit të brendshëm.
8. Bashkëpunon me menaxhimin e lartë për të siguruar që funksioni i auditimit të brendshëm të mos ketë ndërhyrje gjatë përcaktimit të fushës së tij, kryerjes së angazhimeve të auditimit të brendshëm dhe komunikimit të rezultateve.
9. Komunikon me drejtuesin e auditimit të brendshëm për të kuptuar se si funksioni i auditimit të brendshëm po përmbush mandatin e tij.
10. Komunikon këndvështrimin e tij mbi strategjitë, objektivat dhe risqet e Bashkisë Has për të ndihmuar NJAB në përcaktimin e prioriteteve të auditimit.
11. Përcakton kriteret dhe frekuencën e raportimit për risqet e rëndësishme që tejkalojnë tolerancën e riskut të institucionit.
12. Diskuton me Drejtuesin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm çdo konflikt ose mosmarrëveshje me menaxhimin e lartë dhe ofron mbështetjen e nevojshme që auditimi të kryejë detyrën sipas mandatit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Neni 19
Përgjegjësitë e Menaxhimit të Lartë

Niveli i lartë i drejtimit në Bashkinë Has, përveç detyrimeve ligjore, duhet të përmbushë kushtet e Standardit për Pavarësinë Organizative të cilat përfshijnë:

1. Pozicionon funksionin e auditimit të brendshëm brenda njësisë publike në një nivel që i mundëson të kryejë shërbimet dhe përgjegjësitë pa ndërhyrje, siç udhëzohet nga kryetari i Bashkisë.
2. Njohin dhe respektojnë marrëdhënien e drejtpërdrejtë të raportimit të Drejtuesit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm me Kryetarin e Bashkisë.
3. Bashkëpunojnë për identifikimin e çdo cenimi të mundshëm të pavarësisë së funksionit të auditimit të brendshëm dhe mbështesin zbatimin e masave mbrojtëse për të menaxhuar cënime të tilla.
4. Të sigurojë burime të mjaftueshme – staf, sisteme dhe buxhete – për të mbështetur auditimin, kontrollin dhe funksionet e qeverisjes.
5. Të sigurojë që niveli i lartë drejtues dhe/ose komiteti i auditimit të rishikojnë dhe të aprovojnë formalisht të gjitha dokumentet kryesore financiare, deklaratat e qeverisjes dhe vlerësimet e kontrollit të brendshëm.

Neni 20
Përgjegjësitë e Njësisë së Audituar (Drejtoritë/Sektorët)

Menaxhimi i çdo strukture të Bashkisë Has që i nënshtrohet auditimit, ka këto detyrime:

1. Krijon dhe mban një sistem efektiv kontrolli të brendshëm (MFK) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kryen shqyrtime vjetore të këtyre sistemeve.
2. Siguron qasje të pakufizuar në dokumente, të dhëna, personel, asete dhe ambiente.
3. Dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet i plotë që në fillim të angazhimit të auditimit.
4. Cakton persona të kualifikuar për të ndihmuar audituesit gjatë pyetjeve dhe verifikimeve në terren.
5. Lehtësojë funksionin e auditimit të brendshëm duke ofruar informacion dhe bashkëpunim në kohë gjatë gjithë ciklit të auditimit.
6. Harton brenda afateve planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, duke caktuar përgjegjësit dhe datat specifike.
7. Monitorojë përfundimin e veprimeve korrigjuese dhe të raportojë gjendjen te drejtimi i lartë ose Komiteti i Auditimit (nëse ka).
8. Vendos kontrolle për parandalimin e mashtrimit (Njësia e Auditimit të Brendshëm ofron siguri, por nuk mban përgjegjësi operacionale për zbulimin e tyre).
9. Vendosë kontrolle efektive për zbulimin e mashtrimeve dhe të rishikojë funksionimin e tyre çdo vit.
10. Raporton menjëherë çdo dyshim për shkelje ose mashtrim dhe bashkëpunon në hetime.
11. Rishikon dhe rregullon politikat e punës në mënyrë të vazhdueshme si përgjigje ndaj rekomandimeve të auditimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Neni 21
Komiteti i Auditimit (KA)

Komiteti i Auditimit është një organ këshillimor që mbështet Titullarin dhe Njësinë e Auditimit të Brendshëm për monitorimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut. Në mungesë të këtij organi në Bashkinë Has, funksionet e tij mbikëqyren drejtpërdrejt nga Titullari i Institucionit. Përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit konsistojnë në:

- Marrjen e opinionit për Kartën e Auditimit, Planet Strategjike dhe Vjetore, si dhe raportimin e veprimtarisë vjetore.
- Bashkëpunimin me menaxhimin për risqet që i kanosen sistemit të KBFP (Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik).
- Kërkimin e sigurisë nga menaxhimi i lartë nëse janë adresuar siç duhet gjetjet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm (KLSH).
- Ndërhyrjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë procesit të auditimit.
- Bashkëpunimin nëse janë njoftuar organet kompetente në rastet e mashtrimeve potenciale, korrupsionit të dyshuar apo abuzimeve të evidentuara në raporte.
- Komiteti i Auditimit bashkëpunon në përgatitjen e raportit vjetor të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për t'u dërguar në strukturën përgjegjëse të harmonizimit në Ministrinë e Financave.

Neni 22
Përgjegjësitë e Drejtuesit të Auditimit të Brendshëm

1. Drejtuesi i auditimit të brendshëm është përgjegjës për menaxhimin e të gjithë veprimtarisë audituese në Bashkinë Has, në përputhje me Kartën e Auditimit dhe Standardet Globale (SGAB). Ai mban përgjegjësinë përfundimtare për planifikimin strategjik, shpërndarjen e burimeve dhe performancën e funksionit, edhe në rastet kur delegon detyra te audituesit e tjerë.
   - Në rastet kur pozicioni i Drejtuesit është vakant, qeverisja e funksionit realizohet nga personi i autorizuar zyrtarisht nga Kryetari i Bashkisë.
2. Funksionet Menaxheriale dhe Raportimi:
   - Drejtuesi i auditimit të brendshëm zhvillon mbledhje të rregullta me Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar mandatin, risqet dhe promovimin e rolit të auditimit në institucion.
   - Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të konfirmojë me shkrim pavarësinë organizative te Titullari të paktën një herë në vit, duke dokumentuar çdo cenim apo masë mbrojtëse të ndërmarrë.
   - Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet t'i sigurojë titullarit informacionin e nevojshëm për të ushtruar përgjegjësitë e mbikëqyrjes. Ai/ajo duhet të vlerësojë nëse burimet (buxheti, njerëzit, teknologjia) janë të mjaftueshme për të përmbushur planin vjetor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

- Drejtuesi duhet të zhvillojë, zbatojë dhe mirëmbajë një program të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimi që përfshin të gjitha aspektet e funksionit të auditimit të brendshëm. Drejtuesi duhet të përgatisë një plan për vlerësim të jashtëm të cilësisë dhe ta diskutojë atë me Titullarin e Bashkisë. Ky vlerësim i jashtëm duhet të realizohet të paktën çdo pesë vjet nga një vlerësues i pavarur i kualifikuar, struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, ose ekip vlerësimi kombëtar dhe/ose ndërkombëtar.

3. Përgjegjësitë e drejtuesit të auditimit të brendshëm si mbikëqyrës gjatë angazhimit të auditimit përfshijnë:
   - Puna e stafit të auditimit në çdo nivel dhe fazë të auditimit duhet të mbikëqyret dhe puna e dokumentuar duhet të rishikohet nga Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm, para se opinionet në projekt raportet / raportet e auditimit të marrin formën përfundimtare.
   - Mbikëqyrja dhe kontrolli i duhur, është e nevojshme në të gjitha rastet, pavarësisht nga eksperienca dhe kompetencat e secilit auditues.
4. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet:
   - Të caktojë grupin e punës që do kryejë angazhimin e auditimit;
   - Të sigurohet që anëtarët e grupit të auditimit të kenë një njohje të qartë dhe të thellë të njësisë që do të auditohet, planit të auditimit dhe respektimin e afateve për secilin auditim;
   - Të sigurohet që planifikimi i auditimit dhe hapat e veprimit, të përcaktuara në Programin e Auditimit janë ndjekur .
   - Të mbikëqyrë në mënyrë të vazhdueshme dhe të kërkojë informacion mbi ecurinë angazhimit dhe realizimin e objektivit të auditimit;
   - Të ndjekë të gjitha procedurat për sigurimin e cilësisë;
   - Të sigurohet që auditimi është kryer në përputhje me Rregullat dhe Procedurat e miratuara të auditimit;
   - Të rishikojë projekt - raportin /raportin e auditimit nëse është hartuar sipas strukturës dhe metodologjisë të parashikuar në manualin e auditimit të brendshëm;
   - Të sigurohet që letrat e punës përmbajnë të dhëna ku mbështeten të gjitha gjetjet, konkluzionet, rekomandimet dhe opinionet;
   - Të miratojë projekt raportin dhe raportin e angazhimit;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

KREU V

KOORDINIMI DHE MARRËDHËNIET ME JASHTË

Neni 23
Metodologjia e Punës dhe Përmirësimi i Funksionit

1. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm harton dhe zbaton metodologji sistematike për të udhëhequr funksionin e auditimit, në përputhje me Standardet Globale (SGAB) dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm.
2. Metodologjia e dokumentuar e Bashkisë Has duhet të mbulojë:
   - Vlerësimin e risqeve për Bashkinë dhe për çdo angazhim.
   - Zhvillimin dhe përditësimin e planit të auditimit të brendshëm.
   - Përcaktimin e ekuilibrit ndërmjet angazhimeve të sigurimit dhe këshillimit.
   - Koordinimin me ofruesit e sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm.
   - Menaxhimin e ofruesve të shërbimeve të jashtme, kur përdoret.
   - Kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm.
   - Komunikimin përmes shërbimeve të auditimit të brendshëm.
   - Ruajtjen dhe nxjerrjen e të dhënave të angazhimit dhe informacioneve të tjera, në përputhje me udhëzimet e njësisë publike dhe kërkesat përkatëse rregullatore ose të tjera.
   - Monitorimin dhe konfirmimin e zbatimit të rekomandimeve të audituesve të brendshëm ose planeve të veprimit të menaxhimit.
   - Sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e funksionit të auditimit të brendshëm.
   - Zhvillimin e matjeve të performancës për të vlerësuar progresin drejt përmbushjes së objektivave.
   - Kryerjen e shërbimeve shtesë të identifikuara në mandatin e auditimit të brendshëm.
3. Metodologjitë rishikohen periodikisht, sidomos kur ndryshojnë standardet, teknologjia ose kur ka ndryshime rrënjësore në strukturën e Bashkisë.

Neni 24
Koordinimi me Ofruesit e Sigurisë dhe Shërbimet e Jashtme

1. Njësia e Auditimit të Brendshëm bashkëpunon me Kontrollin e Lartë të Shtetit, strukturën e harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe audituesit e donatorëve të huaj për të minimizuar mbivendosjet dhe për të rritur efiçencën e kontrollit.
2. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm vë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit raportet e përfunduara dhe informacionet e nevojshme mbi statusin dhe pavarësinë e njësisë.
3. Adituesit e KLSH në aktivitetet e tyre vlerësojnë aspektet e punës së AB, të tilla si statusi i AB, pavarësia, cilësia dhe metodologjia e punës dhe kapaciteteve trajnuese.
   Bazuar në këto parime, fushat kryesore të bashkëpunimit janë:
   - Shkëmbimi i informacionit dhe i raporteve të auditimit.
   -Trajnimet e përbashkëta dhe zhvillimi i metodologjive të kontrollit.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Neni 25
Raportimi te Struktura e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (Ministria e Financave)

Drejtuesi i auditimit të brendshëm raporton dhe mban kontakte të rregullta me strukturën përgjegjëse të harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë përgjegjëse për Financat. Më konkretisht ky bashkëveprim konsiston në:

- Përgatitjen e planeve strategjike dhe vjetore të veprimtarisë së auditimit të brendshëm të njësive të AB;
- Përcaktimin dhe zhvillimin e sistemit të raportimit të rezultateve për veprimtaritë e auditimit të brendshëm në sektorin publik,
- Hartimin e raportit vjetor të konsoliduar si pjesë e raportit vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik.
- Zhvillimin dhe zbatimin e një metodologjie efiçente për garantimin e cilësisë së veprimtarisë AB, në përputhje me standardet globale të pranuara të auditimit të brendshëm;
- Evidentimin e kërkesave për trajnimin e vazhdueshëm profesional të audituesve të brendshëm.
- Raportimin kur ndodhin ndryshime në strukturat e auditimit të brendshëm, (rekrutime/largime të stafit).
- Evidentimin e kërkesave për certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik.
- Planifikimin dhe kryerjen e auditimeve horizontale, me qëllim verifikimin dhe vlerësimin e projekteve, aktiviteteve ose programeve të përbashkëta/të ngjashme që kryhen në dy ose më shumë subjekte publike. Objektivat dhe fusha e auditimeve horizontale duhet të komunikohet në formën e përcaktuar, pasi të jetë rënë dakord me njësitë e auditimit të brendshëm, të përfshira në angazhimet horizontale të auditimit.
- Dërgimin e planit vjetor të auditimit të ndryshuar gjatë procesit të zbatimin të tij me qëllim që ato të reflektohen në planin vjetor të konsoliduar për veprimtarinë dhe funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në shkallë vendi.

Neni 26
Marrëdhëniet me Inspektimin Financiar

1. Nëse gjatë një angazhimi, audituesi i brendshëm konstaton parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e tyre, dyshohet se përbëjnë shkelje të rëndë dhe keqmenaxhim të rëndë financiar, ndërpret auditimin dhe informon menjëherë me shkrim nëpërmjet përgjegjësit të grupit tek drejtuesi i auditimit të brendshëm, i cili raporton menjëherë me shkrim tek titullari i njësisë publike.
2. Drejtuesi i auditimit të brendshëm nëpërmjet një raporti i ndërmjetëm informon me shkrim titullarin e njësisë publike duke pasqyruar në mënyrë të përmbledhur parregullsitë / veprimet apo mosveprimet, të mbështetura me evidenca.
3. Titullari ka detyrimin ligjor të dërgojë këtë raport menjëherë te Ministri i Financave për nisjen e Inspektimit Financiar Publik.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

KREU VI

LIOJET E ANGAZHIMEVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Shërbimet e ofruara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has ndahen në:

- Shërbime të Sigurisë dhe
- Shërbime të Këshillimit.

Natyra e veprimtarisë së auditimit të brendshëm është veprimtari "pas faktit" (ex-post), që do të thotë se vlerëson proceset dhe veprimet pasi ato kanë ndodhur.

Neni 27
Shërbimet e Sigurisë

1. Përmes shërbimeve të sigurisë, audituesit kryejnë vlerësime objektive për të rritur nivelin e besimit të palëve të interesuara mbi qeverisjen, menaxhimin e riskut dhe proceset e kontrollit në Bashkinë Has.
2. Llojet e angazhimeve të sigurisë përfshijnë auditimet:
   - Auditimi i Përputhshmërisë: Për të verifikuar nëse veprimtaria është në përputhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat në fuqi.
   - Auditimi Financiar: Për të vlerësuar besueshmërinë dhe integritetin e informacionit financiar.
   - Auditimi i Performancës: Për të vlerësuar nëse burimet janë përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet (3E-të).
   - Auditimi i Sistemeve të TI: Për të vlerësuar sigurinë dhe funksionimin e sistemeve teknologjike.
3. Shkalla e sigurisë së ofruar mund të jetë e kufizuar ose e arsyeshme, varësisht nga procedurat e kryera.

Neni 28
Shërbimet e Këshillimit

1. Shërbimet e këshillimit janë aktivitete me natyrë këshilluese dhe shërbime të lidhura me to, të cilat kryhen me kërkesë të Titullarit të Bashkisë.
2. Përmes këshillimit, audituesit ofrojnë udhëzime profesionale pa marrë përsipër përgjegjësitë e menaxhimit.
3. Shembujt përfshijnë: hartimin e politikave të reja, trajnimet, investigimet dhe diskutimet mbi risqet.
4. Këto shërbime kryhen vetëm mbi bazën e një marrëveshjeje me palët e interesit dhe pas vlerësimit se nuk cenohet pavarësia e audituesit.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

KREU VII

PLANIFIKIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Neni 29
Natyra Strategjike e Planifikimit

1. Planifikimi i auditimit në Bashkinë Has është një proces strategjik dhe sistematik që synon maksimizimin e vlerës që ky funksion i sjell institucionit.
2. Drejtuesi i auditimit të brendshëm mban përgjegjësinë përfundimtare për menaxhimin e ciklit të planifikimit, në përputhje me Kartën e Auditimit dhe SGAB.
3. Cikli i planifikimit në Bashkinë Has është i ndarë në tre nivele hierarkike:
   - Planifikimi Strategjik: Përcakton drejtimin afatgjatë (zakonisht 3-vjeçar).
   - Planifikimi Vjetor: Detajon angazhimet specifike që do të kryhen gjatë një viti kalendarik.
   - Planifikimi i Angazhimit: Përcakton hapat konkretë për çdo mision auditimi individual.

Neni 30
Auditimi i Bazuar në Risk

1. Plani i auditimit duhet të bazohet parësisht në vlerësimin e riskut. Kjo do të thotë se Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të prioritizojë ato aktivitete, programe apo departamente ku mundësia për gabime, humbje apo dështim të objektivave është më e lartë.
2. Qëllimi i kësaj qasjeje është:
   - Përmirësimi i proceseve të qeverisjes.
   - Forcimi i menaxhimit të riskut.
   - Rritja e efektivitetit të kontrollit të brendshëm (KBFP).

Neni 31
Burimet dhe Metodologjia

1. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm duhet të sigurojë që funksioni i auditimit është i pozicionuar në mënyrë strategjike dhe zotëron:
   - Staf me kompetenca të duhura dhe buxhet operacional.
   - Procedura të qarta për çdo fazë të punës.
   - Ndërveprim i vazhdueshëm me Titullarin dhe menaxhimin.
2. Delegimi i detyrave të planifikimit te audituesit e tjerë është i lejuar, por mbikëqyrja dhe përgjegjësia finale mbetet te Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

KREU VIII

KUPTIMI I QEVERISJES, RISKUT DHE KONTROLLIT

Neni 32
Vlerësimi i Proceseve të Qeverisjes

1. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm duhet të vlerësojë pjekurinë e qeverisjes në Bashkinë Has, duke u bazuar në parimet globale dhe strukturën unike të institucionit (madhësia, kompleksiteti, kërkesat ligjore).
2. Për të fituar njohuri mbi vendimmarrjen strategjike, Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm rishikon:
   - Statutet, agjendat dhe procesverbalet e mbledhjeve të Kryetarit dhe Këshillit Bashkiak.
   - Raportet e mëparshme të qeverisjes dhe etikës.
3. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm mban kontakte me personelin kyç (Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Burimeve Njerëzore) për të kuptuar mjedisin e kontrollit.

Neni 33
Menaxhimi i Riskut

1. Njësia e Auditimit të Brendshëm vlerëson nëse Bashkia Has ka përcaktuar "oreksin për risk" dhe nëse ka një strategji funksionale për menaxhimin e tij.
2. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm mbledh informacion mbi riskun duke rishikuar:
   - Regjistrat e riskut të Bashkisë.
   - Komunikimet zyrtare mbi risqet kritike.
   - Raportet e KLSH-së dhe rregullatorëve të tjerë të jashtëm.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Neni 34
Proceset e Kontrollit dhe Matrica e Riskut

1. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm dokumenton proceset e kontrollit të Bashkisë dhe vlerëson efektivitetin e tyre.
2. Për çdo objektiv të institucionit, Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm zhvillon dhe mirëmban një Matricë Risku dhe Kontrolli për të:
   - Dokumentuar risqet që pengojnë arritjen e objektivave.
   - Identifikuar kontrollet kyçe që menaxhojnë këto risqe.
   - Verifikuar nëse këto kontrolle janë projektuar saktë dhe funksionojnë siç duhet.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Neni 35
Lidhja me Strategjinë e Auditimit

Kuptimi i plotë i Qeverisjes, Riskut dhe Kontrollit shërben si baza e vetme mbi të cilën ndërtohet Strategjia dhe Plani i Auditimit të Brendshëm. Kjo i mundëson Njësisë së Auditimit të Brendshëm të prioritizojë shërbimet që i shtojnë vlerë suksesit të Bashkisë Has.

Neni 36
Miratimi dhe Afatet e Planeve

Afati kohor për zhvillimin dhe miratimin të Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm

1. Drejtuesi i auditimit të brendshëm zhvillon një plan të ri strategjik në periudhën qershor-shtator të vitit të fundit të planit strategjik në zbatim.
2. Drejtuesi i auditimit të brendshëm diskuton draftin e Planit Strategjik në shtator të atij viti, me Komitetin e Auditimit, ku ekziston.
3. Drejtuesi i auditimit të brendshëm, pas dakortësimit me Komitetin e Auditimit , ia dërgon Planin Strategjik , titullarit /bordit të njësisë publike deri më 15 tetor të atij viti.
4. Gjatë tetorit, Drejtuesi i auditimit të brendshëm diskuton planin me titullarit /bordit të njësisë publike.
5. Deri në datën 31 Tetor të atij viti, titullari /bordi i njësisë publike duhet të miratojë Planin Strategjik për periudhën e ardhshme 3 vjeçare.
6. Deri në datën 5 Nëntor të atij viti, Drejtuesi i auditimit të brendshëm e dërgon Planin Strategjik të miratuar tek struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB, e cila bën analizën dhe konsolidimit për të gjithë funksionin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.
7. DH AB dërgon dokumentin e konsoliduar tek Ministri përgjegjës për financat dhe palët e tjera të interesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për auditimin e brendshëm dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

- **Monitorimi i planit strategjik**

1. Çdo vit, Drejtuesi i auditimit të brendshëm rishikon planin strategjik në periudhën qershor-shtator.
2. Drejtuesi i auditimit të brendshëm diskuton draftin e Raportit të Monitorimit të Planit Strategjik në shtator të atij viti, me Komitetin e Auditimit, ku ekziston.
3. Drejtuesi i auditimit të brendshëm, pas dakortësimit me Komitetin e Auditimit, ia dërgon Raportin e Monitorimit, titullarit /bordit të njësisë publike deri më 15 tetor të atij viti.
4. Gjatë tetorit, Drejtuesi i auditimit të brendshëm diskuton Raportin e Monitorimit me titullarin /bordin të njësisë publike.
5. Deri në datën 31 Tetor të atij viti, titullari /bordi i njësisë publike duhet të miratojë Raportin e Monitorimit dhe ndryshimet e nevojshme nëse ka.
6. Deri në datën 5 Nëntor të atij viti, Drejtuesi i auditimit të brendshëm e dërgon Raportin e Monitorimit të Planit Strategjik të miratuar tek struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB, e cila bën analizën dhe konsolidimit për të gjithë funksionin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

7. DH AB dërgon dokumentin e konsoliduar tek Ministri përgjegjës për financat dhe palët e tjera të interesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për auditimin e brendshëm.

KREU IX

FAZAT E KRYERJES SË ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT

Neni 37
Fillimi dhe Planifikimi i Angazhimit

1. Çdo angazhim auditimi nis me përgatitjen e Autorizimit dhe dërgimin e Njoftimit për Auditim drejtuar njësisë që do të auditohet.
2. Drejtuesi i grupit organizon një takim fillestar me drejtuesit e njësisë së audituar për të prezantuar qëllimin e auditimit.
3. Gjatë kësaj faze, grupi i auditimit:
   - Identifikon kuadrin ligjor dhe mbledh informacionin paraprak.
   - Kryen vlerësimin fillestar të risqeve dhe përcakton objektivat e fushën e auditimit.
   - Harton dhe dokumenton Programin e Punës së Auditimit, i cili miratohet nga Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Neni 38
Puna në Terren

1. Audituesit kryejnë punën e detajuar në terren (testimet, verifikimet, kampionimet) në përputhje me programin e miratuar.
2. Pas përfundimit të verifikimeve, organizohet një takim me njësinë e audituar për të diskutuar gjetjet paraprake dhe për të sqaruar çdo paqartësi të mbetur.

Neni 39
Raportimi i Rezultateve

1. Hartohet drafti i parë i raportit i cili i dërgohet njësisë së audituar.
2. Njësia e audituar ka të drejtë të japë komentet e saj me shkrim brenda afateve ligjore.
3. Pas shqyrtimit të komenteve, Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm finalizon raportin, i cili përmban gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësim.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Neni 40
Ndjekja e Rekomandimeve (Follow-up)

1. Njësia e audituar është e detyruar të dorëzojë një plan me masa korrigjuese dhe afate për zbatimin e rekomandimeve.
2. NJAB monitoron në mënyrë të rregullt shkallën e zbatimit të këtyre masave dhe raporton periodikisht te Titullari i Bashkisë Has mbi ecurinë e tyre.

KREU X

PAVARËSIA DHE OBJEKTIVITETI

Neni 41
Dimensionet e Pavarësisë

Titullari i Bashkisë Has është përgjegjës për të siguruar dhe mbrojtur pavarësinë e funksionit të auditimit të brendshëm.
Pavarësia e NJAB bazohet në dy dimensione kryesore:

- Liria nga presionet, kufizimet ose ndërhyrjet që kompromotojnë aftësinë për të dhënë vlerësime të paanshme.
- Gjendja mendore që lejon audituesit të kryejnë punën pa asnjë paragjykim apo konflikt interesi.

Neni 42
Raportimi Funksional dhe Administrativ

Për të garantuar pavarësinë, struktura e raportimit në Bashkinë Has është si vijon:

1. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm raporton drejtpërdrejt te Kryetari i Bashkisë (Titullari) dhe, nëse ekziston, te Komiteti i Auditimit. Ky raportim përfshin miratimin e planeve, rezultatet e auditimeve dhe vlerësimin e pavarësisë.
2. Për çështje të përditshme (si pushimet, burimet njerëzore etj.), raportimi bëhet në nivelin më të lartë ekzekutiv (p.sh. Sekretari i Përgjithshëm), duke ruajtur autoritetin për të sfiduar çdo vendimmarrje menaxheriale.

Neni 43
Mbrojtja ndaj Ndërhyrjeve (Cenimi i Pavarësisë)

Konsiderohen ndërhyrje të panevojshme dhe duhen raportuar menjëherë te Titullari:

- Kufizimi i aksesit në të dhëna, personel ose prona fizike.
- Presioni për të ndryshuar ose fshehur gjetjet e auditimit.
- Reduktimi i pajustifikuar i buxhetit që pengon realizimin e planit.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm duhet të konfirmojë pavarësinë organizative para Titullarit të paktën një herë në vit.

Neni 44
Kufizimet për Rolet Jo - Audituese (Rregulli i 3 Viteve)

Kur Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm ose audituesit kanë pasur pozicione operacionale brenda Bashkisë, ata nuk mund të auditojnë atë fushë për një periudhë prej **3 vitesh** (sipas SGAB).

Në raste emergjente kur kërkohet ekspertiza e NJAB për role jo-audituese (p.sh. ngritja e kontrolleve të reja):

- Duhet të specifikohet një afat kohor për dorëzimin e përgjegjësisë te menaxhimi.
- Për 12 muajt pasardhës, siguria për atë fushë duhet të ofrohet nga një palë e tretë e pavarur.

Neni 45
Masat Mbrojtëse dhe Zgjidhja e Konflikteve

1. Nëse pavarësia cënohet pas përfundimit të një auditimi, Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm duhet ta diskutojë këtë me Titullarin dhe menaxhimin e lartë për të përcaktuar nëse gjetjet mbeten të besueshme.
2. Në rastet kur struktura drejtuese nuk e mbështet pavarësinë, Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm duhet të dokumentojë shkaqet dhe të njoftojë strukturat monitoruese në Ministrinë e Financave.

Neni 46
Dokumentimi dhe Ruajtja e Letrave të Punës (Arkivimi).

1. Audituesit e brendshëm duhet të dokumentojnë informacionin dhe dëshmitë në mënyrë të tillë që një audites tjetër kompetent të mund të përsërisë punën (reperformancë) dhe të nxjerrë të njëjtat rezultate.
2. Çdo dosje auditimi në Bashkinë Has duhet të jetë e plotë dhe të përmbajë (por pa u kufizuar në):

   - Autorizimin dhe Deklaratën e Konfliktit të Interesit.
   - Njoftimin e fillimit dhe Vlerësimin e Riskut (të mjedisit të kontrollit dhe sistemeve).
   - Programin e punës dhe ndarjen e detyrave.
   - Procesverbalet e takimeve (Prezantues, Fillimit të terrenit, Përmbyllës).
   - Testet individuale dhe evidencat mbështetëse.
   - Projekt-Raportin, Kundërshtimet e subjektit dhe Raportin Final.
   - Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve.
   - Listat e kontrollit të cilësisë (nga audituesi, përgjegjësi i grupit dhe Drejtuesi i NJAB).

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

3. Përgjegjësi i grupit rishikon dokumentacionin për saktësi dhe rëndësi, ndërsa Drejtuesi i NJAB shqyrton dhe miraton dosjen finale si bazë për vlerësimin e cilësisë dhe përputhshmërinë me Standardet.
4. Dokumentet e punës organizohen sipas strukturës së programit të punës dhe duhet të ndërlidhen me pjesët përkatëse të informacionit.
5. Në përfundim të çdo angazhimi, dosja e auditimit bashkë me inventarin përkatës duhet të arkivohet sipas kuadrit ligjor për arkivat dhe normave tekniko-profesionale në fuqi. Arkivimi duhet të sigurojë integritetin e dokumentit dhe mbrojtjen nga aksesi i paautorizuar.

Neni 47
Mbrojtja e Informacionit dhe Aksesi i Palëve të Treta.

1. Audituesit e brendshëm duhet të mbrojnë konfidencialitetin e dokumenteve të punës dhe të dhënave të siguruara gjatë auditimit. Informacioni nuk mund t'u zbulohet palëve të treta pa autorizim përkatës, përveç rasteve kur ka një detyrim ligjor.
2. Çdo kërkesë nga palë të treta (p.sh. auditues të jashtëm, KLSH, ose organe hetimore) për të parë apo marrë kopje të letrave të punës, duhet të miratohet paraprakisht nga Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm në konsultim me Titullarin e Bashkisë Has.
3. Dokumentet elektronike dhe korrespondenca (e-mail) që shërben si dëshmi auditimi, duhet të ruhen në serverat e Bashkisë me nivele të larta sigurie dhe backup-i periodik.

KREU XI

PROGRAMI I SIGURIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË (PSPC)

Neni 48
Qëllimi dhe Fushëveprimi i PSPC

1. PSPC hartohet për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të NJAB, në përputhje me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm (SGAB) dhe legjislacionin në fuqi.
2. Ky program mbulon të gjitha aspektet e funksionit të auditimit, duke siguruar që misionet e auditimit të shtojnë vlerë në qeverisjen, menaxhimin e riskut dhe performancën e Bashkisë Has.
3. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe përditësimin e PSPC-së.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Neni 49
Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë

Vlerësimi i brendshëm realizohet përmes dy mekanizmave:

1. Monitorimi i Vazhdueshëm: Mbikëqyrja e përditshme e angazhimeve, rishikimi i letrave të punës në kohë, përdorimi i listave të kontrollit (Aneksi 3, Formati 18/19) dhe marrja e reagimeve (feedback) nga njësitë e audituara pas çdo misioni.
2. Vetëvlerësimet Periodike: Të paktën një herë në vit, Njësia e Auditimit të Brendshëm kryen një vetëvlerësim të plotë të funksionit për të vlerësuar përshtatshmërinë e metodologjisë dhe përmbushjen e objektivave të performancës.

Neni 50
Treguesit Kryesorë të Performancës

Për të matur efektivitetin e funksionit, Njësia e Auditimit të Brendshëm ndjek tregues si:

- Përqindja e realizimit të planit vjetor të auditimit.
- Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga menaxhimi.
- Niveli i kënaqësisë së palëve të interesuara.
- Zhvillimi profesional dhe certifikimi i audituesve.

Neni 51
Vlerësimet e Jashtme të Cilësisë

1. Njësia e Auditimit të Brendshëm i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm të cilësisë nga struktura përgjegjëse për harmonizimin në Ministrinë e Financave.
2. Ky vlerësim kryhet të paktën një herë në 5 vjet, ose bazuar në vlerësimin e riskut, ankesat e pranuara apo kërkesën e vetë Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Neni 52
Raportimi dhe Plan Veprimi për Cilësinë

1. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm raporton te Titullari (Kryetari) rezultatet e vlerësimeve të brendshme (vjetore) dhe të jashtme.
2. Në rast mospërputhjesh me Standardet, Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm harton një Plan Veprimi me afate të caktuara për adresimin e mangësive dhe ia komunikon atë Titullarit/Bordit.
3. Programi i Sigurimit dhe Përmirësimit të Cilësisë (PSPC-ja) e miratuar i dërgohet Ministrisë së Financave për informim.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

KREU XII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 53
Njohja dhe zbatimi i rregullores

1. Të gjithë nëpunësit dhe punonjësit e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, si dhe drejtuesit e strukturave që i nënshtrohen auditimit në Bashkinë Has, duhet të njihen individualisht me këtë rregullore. Për çdo sqarim ose interpretim lidhur me zbatimin e saj, punonjësit mund t'i drejtohen Sektorit të Burimeve Njerëzore ose Drejtuesit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm.
2. Për punonjësit e Bashkisë Has, detyrat e të cilëve nuk parashikohen shprehimisht në këtë rregullore, mbeten në fuqi përcaktimet e kontratës individuale të punës (sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë), Ligji "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, si dhe legjislacioni specifik në fuqi.
3. Të gjithë punonjësit do të njihen zyrtarisht me këtë rregullore menjëherë pas miratimit të saj nga Kryetari i Bashkisë. Rregullorja do të jetë e aksesueshme në çdo kohë përmes publikimit në faqen zyrtare të Bashkisë Has.

Neni 54
Masat Disiplinore dhe Sanksionet

1. Çdo veprim ose mosveprim i punonjësve të Bashkisë Has, që bie në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore, konsiderohet shkelje disiplinore dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Sanksionet do të aplikohen veçanërisht në rastet kur:

   - Pengon pa arsye procesin e auditimit (mosdhënia e dokumentacionit ose informacionit).
   - Jepen të dhëna të rreme ose të pasakta me qëllim fshehjen e parregullsive.
   - Nuk zbatohen rekomandimet e lëna nga auditimi brenda afateve të përcaktuara.
   - Shkelet parimi i konfidencialitetit të informacionit.

3. Për shkeljet e mësipërme, në varësi të shkallës së rëndësisë, aplikohen masat e parashikuara në Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" (për nëpunësit) ose në Kodin e Punës (për punonjësit me kontratë), që përfshijnë:
   - Vërejtje;
   - Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna;
   - Pezullim nga detyra;
   - Zgjidhje e marrëdhënies së punës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has, Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

4. Aplikimi i masave disiplinore nuk përjashton përgjegjësinë penale apo civile, nëse shkelja e konstatuar përmban elemente të veprës penale apo ka shkaktuar dëm financiar të drejtpërdrejtë për institucionin.

Neni 55
Hyrja në Fuqi dhe Rishikimi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Bashkisë Has.
2. Rregullorja është një dokument dinamik dhe do të rishikohet sa herë që ka ndryshime në kuadrin ligjor, Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm (SGAB) apo strukturën organizative të institucionit.

Konceptoi:

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Esmeralda Zyberaj

KRYETAR

Miftar DAUTI

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has, Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al